

## **Presidenti i Çalik Holding, z. Ahmet Çalik vlerësohet me titullin “Doctor Honoris Causa” nga Universiteti i Tiranës**

Në një ceremoni të veçantë, Universiteti i Tiranës i ka akorduar Presidentit të Çalik Holding, z. Ahmet Çalik titullin “Doctor Honoris Causa”.

Rektori i këtij universiteti, Prof. Dr. Dhori Kule i ka dorëzuar z. Çalik Diplomën “Doctor Honoris Causa”, me motivacionin “Për kontribut të veçantë dhe këmbëngulje të pashoqe në zhvillimin e ekonomisë shqiptare, si dhe për vlerësimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të universiteteve në Shqipëri”.

Pjesëmarrës në këtë ceremoni kanë qenë anëtarë të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, Ministra e Arsimit dhe Sporteve, znj. Lindita Nikolla, akademikë shqiptarë e të huaj, Ambasadori i Republikës Turke në Shqipëri, z. Hidayet Bayraktar, Drejtori i Përgjithshëm i ALBtelecom dhe Eagle Mobile, Dr. Erkan Tabak, Drejtori i Përgjithshëm i BKT, Dr. Seyhan Pencapligil, si dhe gazetarë e njerëz të biznesit.

Gjatë recensës së tij për dhënien e titullit “Doctor Honoris Causa”, Prof. Assoc. Dr. Ervin Demo u shpreh se: “Dhënia e këtij titulli nga Universiteti i Tiranës për z. Ahmet Çalik është një rast i mirë për të evidentuar energjitë dhe gjenialitetin e z. Çalik për zhvillimin dhe zgjerimin e biznesit, duke kontribuar kështu në progresin jo vetëm të vendit të tij (Republikës së Turqisë), por edhe të vendeve të tjera, ku investimet e kompanisë së tij janë prezente”.

Ndërkohë, Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Prof. Dr. Sulo Hadëri, duke vlerësuar kontributin e investimeve të z. Çalik ndër vite, si dhe përgjegjësinë e lartë sociale të kompanive të tij, tha se është nder dhe kënaqësi e veçantë që listës së personaliteteve me titullin “Doctor Honoris Causa” t’i bashkohet edhe z. Ahmet Çalik, për kontribute të veçanta e domethënëse në fushën e biznesit në Shqipëri e më gjerë.

Z. Çalik nga ana e tij shprehu kënaqësinë dhe mirënjohjen për vlerësimin e bërë nga Universiteti i Tiranës dhe tha se: “Ndjehem shumë i vlerësuar dhe krenar për këtë titull që më jepet. Ne si Çalik Holding, me investimet që kemi bërë dhe vazhdojmë të bëjmë, ecim me parimin: ‘Të sjellim përfitime për shoqërinë, duke krijuar vlera në të gjitha vendet ku operojmë’. Në këtë drejtim, kompania jonë po ndërmerri projekte të ndryshme të përgjegjesisë sociale”.

Falë meritave të tij në zhvillimin e biznesit dhe kontributit shumë të vlerësuar social, z. Ahmet Çalik është dekoruar me medalje e tituj nderi nga institucione e vende të ndryshme të botës, nga Italia në Japoni.



## **The President of Çalık Holding, Mr. Ahmet Çalık is awarded the Honorary Title of Doctor Honoris Causa by the University of Tirana**

In a special ceremony, the University of Tirana has awarded the honorary title of Doctor Honoris Causa to the President of Çalık Holding, Mr. Ahmet Çalık.

The Rector of the university, Prof. Dr. Dhori Kule has handed out the Doctor Honoris Causa Degree to Mr. Çalık, in recognition of his special contribution and unmatched tenacity in the development of the Albanian economy, as well as the ongoing evaluation and support of universities in Albania.

The ceremony was attended by members of the Academic Senate of the University of Tirana, Albanian and foreign academics, the Minister of Education and Sports, Mrs. Lindita Nikolla, the Ambassador of the Republic of Turkey to Albania, Mr. Hidayet Bayraktar, the CEO of ALBtelecom and Eagle Mobile, Dr. Erkan Tabak, the CEO of BKT, Dr. Seyhan Pencapligil, journalists and business people.

During his speech at the Doctor Honoris Causa ceremony, Assoc. Prof. Dr. Ervin Demo said: "The award of this honorary title by the University of Tirana to Mr. Ahmet Çalık is a good opportunity to highlight the energies and genius of Mr. Çalık in business development and expansion, thus contributing not only to the progress of his home country (the Republic of Turkey) but also of other countries where his companies' investments are present".

Meanwhile, the Dean of the Faculty of Economics, Prof. Dr. Sulo Hadëri, appreciating the contribution of Mr. Çalık's investments over the years, as well as his companies' corporate social responsibility, said that it is an honor and pleasure that Mr. Ahmet Çalık joins the list of personalities who have received the honorary title Doctor Honoris Causa, for special and significant contributions in the field of business in Albania and beyond.

Mr. Çalık, in turn, expressed his satisfaction and gratitude for the appreciation made by the University of Tirana and said: "I feel honored and proud to be given this title. In all the investments we have made and continue to make, we as Çalık Holding are guided by the principle of bringing benefits to the society, by creating values in all the countries we operate. In this regard, our company is undertaking various projects of social responsibility.

Thanks to his merit in business development and the valuable social contribution, Mr. Ahmet Çalık has been awarded many medals and honorary titles by various institutions and countries in the world, from Italy to Japan.

